Ky vendim është marr duke u bazuar në faktet në vijim: me date 21 mars 2024, Komisioni për Banesa përmes Memorandumit ka propozuar tek Bordi i Drejtorëve, që ta aprovoj Raportin me rekomandime të datës 19.03.2024, për 7 (shtatë kërkesa), përfshirë edhe kërkesën me nr. KB- 1764/23, e parashtruar nga (bashkëshortja e bartësit të së drejtës banesore). Bordi miratoi Raportin me rekomandime të Komisionit për Banesa datës 19.03.2024 me Ref. Nr. BD-200/5 me datë 29.03.2023, dhe aprovon kërkesën për blerjen e banesës në emër të . Komisioni e njoftoi z. , me vendimin e Bordit të Drejtorëve, BD- 200/5 të datës 29.03.2024. Për të vazhduar procedurën për përmbylljen e kontratës, Komisioni e ka informuar palën se duhet të sjellë Aktvendimin mbi trashëgimin për të ndjerin , edhe pse pala ka qenë e njoftuar ma herët nga Komisioni për plotësim të kërkesës me Aktvendim te Trashëgimisë, bazuar në dëshminë e vdekjes së . Rrjedhimisht pala kishte filluar procedurën e trashëgimisë por ende nuk ishte përfunduar sepse palët jetonin jashtë shtetit. Me date 26.08.2024, z. ka sjelle Aktvendimin mbi trashëgimin për të ndjerin bartës i të drejtës banesore, LRP nr. rendor 11078/2024 ref. 3339/2024, në të cilën shpallen trashëgimtar Lecaj (bashkëshortja e bartësit të së drejtës banesore) dhe , (e bija e bartësit të së drejtës banesore). Për ta përmbyllur kontratën nga Divizioni përkatës në Departamentin Ligjor është e nevojshme që në cilësi të blerëses te përfshinë dy trashëgimtaret e cekura si me lartë si bashkëpronare. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe Duke u bazuar në gjendjen faktike vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 30 shtator 2024

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-210/33

Në bazë të nenit 15.2.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 të AKP-së (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115)dhe nenit 18.1.12 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me 30 shtator 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet Rregullorja nr.03/2024 për Angazhimin Ofrueseve të Shërbimeve në Procesin e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, respektivisht shfuqizohet Rregullorja nr. 09/2023 për OSh-të.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Menaxhmenti për Amandamentimin e Rregullores 9/2023 për Angazhimin e Ofrueseve të Shërbimeve në Procesin e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Zyra Kombëtare e Auditimit në raportin e auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2021 për Fondet në Mirëbesim ka rekomanaduar amandamentimin e Rregullores 6/2020, për Angazhimin e Ofrueseve të Shërbimeve në Procesin e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, me qëllim të rregullimit të pagave të Ofruesve të shërbimeve. Si rrjedhojë Bordi i Drejtorëve të AKP-së, ka amandamentuar këtë rregullore në me 28.03.2023, dhe pastaj me aprovimin me datë 28.09.2023 të amendamentimit me rregulloren 09/2023, është konsideruar që është zbatuar e gjetura e auditorit ZKA. Megjithatë pas diskutimeve me NJAB, është konstatuar se përkundër amandamentimit, ende ka mbetur pa u zbatuar e gjetura në tërësi sipas asaj si e konsideron NJAB.
Përveç kësaj, Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 28.08.2024 ka nxjerrë vendimin (nr.02/218) për përcaktimin e pagës minimale në Kosovë, vendim ky që do të filloj së zbatuar nga data 01.10.2024.

Bazuar në të lartcekurat, pra nevojës për zbatimin e të gjeturës/rekomandimit të auditorit, si dhe urgjencën për zbatimin e vendimit të Qeverisë për pagën minimale, është paraqitë nevoja të bëhet amandamentimi i Rregullores 09/2023 për Angazhimin e Ofrueseve të Shërbimeve në Procesin e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, me rregulloren e propozuar nr.03/2024 për OSh-të, krijuar dhe baza ligjore për mundësinë e transferimit të ofruesve të shërbimeve nga një ndërmarrje në tjetër bazuar në kërkesën dhe vlerësimin e autoriteteve të likuidimit

Duke u bazuar në të lartcekurat Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.
Prishtinë, më 30 shtator 2024.

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-210/34

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Nenit 18 të Ligjit nr. 05/L-028 për tatim në të ardhura pesonale, UA 01/2016 e Ministrisë së Financave, neni 14, par.2.1.5.1, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 shtator 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi i Menaxhmentit të AKP-së dhe ndryshohet vendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së Nr. Ref. BD-204/65 i datës 27.06.2024.**
II. **Aprovohet ankesa e palës vetëm sa i përket ushqimit duke ja shtuar edhe vlerën prej 15 € për ushqim, ndërkaq kërkesat tjera refuzohen.**
III. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin/kërkesën e paraqitur nga Menaxhmenti për rishqyrtimin e Vendimit të Bordit Nr. Ref. BD-204/65 të datës 27.06.2024 sipas ankesës së datës 09.08.2024 anëtar i Bordit të Përkohshëm të INEX Sharr Planina për kompenzim të shpenzimeve. Bordi i Agjencisë ne mbledhjen e datës 29.08.2024 ka udhëzuar Menaxhmentin për të trajtuar ankesën në fjalë. Në përputhje me këtë, me datë 09.09.2024, Drejtori Ekzekutiv me vendimin DE 364/2024 ka themeluar Komisionin për shqyrtimin e ankesës në fjalë.
Bordi me vendim i ka caktuar shumën 38 € bazuar ne Ligjin për tatim në të ardhura personale, si dhe ne UA 01/2016 të Ministrisë së Financave, ku UA përcakton shumat për shpenzimet e 1. Udhëtimit dhe 2. Shpenzimet e tjera lidhur me udhëtimin (ushqimi, strehimi). Sipas UA shuma maksimale e kompensimit për udhëtim është 0.16 € për kilometër si në vendim të Bordit, mirëpo Bordi nuk ka vendosur për shpenzimet tjera (ushqimi, strehimi).
Sipas dokumentacionit, ankuesit i skadon kontrata me 28 qershor 2024, dhe sipas pretendimit të tij, AKP i ka ofruar kontratë të re, te cilën ky nuk e ka nënshkruar pa u ndryshuar kushtet sipas kërkesës se tij, me të cilën ka kërkuar të rishikohet vendimi për shpenzimet e udhëtimit, me qellim të rritjes së shumës dhe të shtohet shuma për "shpenzime tjera" përveç udhëtimit, si dhe ka kërkuar qe t'i caktohet një shumë e përafërt me kolegun e tij që paguhet nga SHA Trepça që është 300 €
Komisioni ka konstatuar se shumat e shpenzimit të udhëtimeve zyrtare janë të parapara qartë në Ligjin për tatimin dhe UA të Ministrisë së Financave, e në përputhje me të cilat është edhe vendimi i Bordit nr. Ref. BD-204/65. Sa i përket shpenzimeve tjera, Bordi ka marrë parasysh faktin se mbledhjet e Bordit te Inex mbahen gjatë ditës dhe nuk ka nevojë për strehim/buajtje (hotel). Komisioni në fjalë ka shqyrtuar ankesën dhe sa i përket çështjes së të ardhurave të kolegut të tij të angazhuar nga SHA Trepça dhe konsiderohet se ky pretendim nuk vlen për AKP-në pasi që ai paguhet nga një institucion tjetër, prandaj nuk mund të merret si bazë për vendim ndryshe.
Ndërkaq, lidhur me kërkesën e palës sa i përket kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, Komisioni në fjalë ka rekomanduar aprovimin e kësaj kërkese duke e shtuar edhe vlerën prej 15 €për ushqim, ndërsa kërkesat tjera ka rekomanduar të refuzohen. Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 30 shtator 2024

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-210/35

Në bazë të nenit 15.2.15 dhe 20.2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me 30 shtator 2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Miratohet kërkesa buxhetore për bartjen e mjeteve nga viti 2024 në vitin 2025 në vlerë prej 200,000€ për projektin kapital "Databaza e arkivës së AKP-së (Kodi i projektit 19256).**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

Arsyetim

Në mbledhjen e mbajtur me 30 shtator 2024 Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u miratua duke u bazuar në faktet në vijim:
Projekti kapital për data bazën e arkivës së AKP-së në vlerë prej 200,000€ është projekt i aprovuar nga Bordi i AKP-së për vitin 2024 dhe rrjedhimisht i aprovuar edhe nga Kuvendi dhe si i tillë figuron edhe në Ligjin e buxhetit të vitit 2024.
Qëllimi i projektit ka qenë dhe është ndërtimi një data baze të re e cila do të përmbaj të gjitha informatat dhe të dhënat relevante lidhur me proceset Privatizimit dhe Likuidimit.
Në dëgjimet buxhetore të mbajtura me datën 11 shtator 2024, në MFPT,Agjencia e ka pasqyruar progresin fizik të projektit kapital dhe njëkohësisht e kemi njoftuar Drejtorin e Buxhetit të MFPT, se ky projekt për arsye të anulimit të tenderit (tri here) në mungesë të ofertave dhe ankesave në OSHP mund të mos realizohet tërësisht në vitin 2024.
Nga Departamenti i Buxhetit - MFPT, jemi udhëzuar që deri në fund të muajit shtator 2024 t'i njoftojmë me shkrim përfundimisht nëse projekti nuk mund të realizohet në vitin 2024 dhe si i tillë të kërkohet të bartet në buxhetin e vitit 2025. Duke qenë se me datë 20.08.2024 është shpall anulimi i tenderit për të tretën herë pas pranimit të vendimit të Panelit Shqyrtues të OSHP-së që anulon vendimin e Agjencisë për dhënie të kontratës dhe rrjedhimisht me këtë ka qenë hera e tretë e anulimit dhe sipas parashikimeve projekti nuk mund të realizohet në vitin 2024 andaj për këtë kërkohet bartja për në vitin 2025. Bartja e projektit në vitin 2025 do të rrisë kërkesën buxhetore të vitit 2025 për 200,000€ e cila kërkon aprovim nga MFPT.
Bordi shqyrtoi buxhetin e propozuar nga Menaxhmenti, dhe duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 shtator 2024.

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-210/36

Në bazë të neneve 6A dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) dhe Vendimit përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 04/58 të datës 12 nëntor 2015 për shpronësimin e pronës së paluajtshme nr. 244-0 ZK Sankoc pronë e NSh Drenica (PRN011), Gllogoc, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30 shtator 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet transferimi i pronës së NSh Drenica (PRN011), Gllogoc me detajet e pronës: Prona e paluajtshme nr. 244-0 ZK Sankoc për realizimin e projektit "Ndertimi i Fabrikës së riciklimit dhe përpunimit të nën-produkteve shtazore për nevoja të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës (AUV)", që titulli pronësor të kaloj në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës/Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) në përputhje me Vendimin Përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës për Shpronësim nr. 04/58, të datës 12 nëntor 2015.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Menaxhmenti për dhënie të pëlqimit për regjistrim/bartje në librat kadastral të pronës së paluajtshme nr. 244-0 ZK Sankoc për realizimin e projektit "Ndërtimi i Fabrikës së riciklimit dhe përpunimit të nën-produkteve shtazore për nevoja të AUV, pronë e NSh Drenica, bazuar në vlerësimin nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve në përputhje me Vendimin Përfundimtar Qeverisë së Republikës së Kosovës, për shpronësim nr. 04/58 të datës 12 nëntor 2015 .

Ky vendim është marr duke u bazuar në faktin se me datë 12 nëntor 2015, Qeveria ka nxjerr Vendimin Përfundimtar me nr. 04/58 përmes së cilit është miratuar shpronësimi për interes publik i pronës së paluajtshme nr. 244-0 ZK Sankoc për realizimin e projektit "Ndërtimi i Fabrikës së riciklimit dhe përpunimit të nën-produkteve shtazore për nevoja të AUV pronë e NSh Drenica, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës/AUV. Pas Vendimit Përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 34/178 të datës 13 dhjetor 2023 si dhe zbatimit të të gjitha procedurave ligjore të këtij shpronësimi, më datë 15 shkurt 2023.

AKP ka dërguar shkresën nëpërmjet së cilës janë paraqitur të dhënat e llogarisë bankare dhe shumës për pagesë, më datë 15 janar 2023 kemi pranuar dëshmitë (mjetet në llogarinë Bankare) e pagesës së 20% në vlerë prej 127,778.00€ totale të vlerësimit të pronës së shpronësuar në vlerë prej 638,894.00 €, në emër të shpronësimit të pronës së paluajtshme nr. 244-0 ZK Sankoc pronë e NSh Drenica, dhe që titulli pronësor të kaloj në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës/AUV. AUV më datë 26 shtator 2024 ka dërguar në AKP letër zotimin (për mjetet eventuale shtesë të pagesës) para se të merr vendim Bordi i Drejtorëve i AKP-së për lejimin e bartjes së pronësisë. Për këto arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 30 shtator 2024.

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-210/37

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullores nr, 02/2024 për qiradhënie të aseteve të NSh-ve, Neni 2.5 i Kontratave të Qirasë të nënshkruara në mes të Autoritetit të Likuidimit të NSh "Tregu" dhe parashtruesve të kërkesave, nenit 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me 30 shtator 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për transferimin e kontratave të qirasë tek NSh Tregu:
   a) Nga Besim Stublla si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr.91 tek Tregu me Shumicë në Zonën Industriale Prishtinë, në sipërfaqe prej 100m2 tek N.T.P "Bizhuteria Noli" përfaqësuar nga Agim Lahu në shumën prej 300.00 Euro/muaj;
   b) Nga Skender Rukovci si qiramarrës i pjesës hapësirave afariste nr.703,704,725,726 dhe 3/A e cila ndodhet në Tregun te ish-Amortizatorët tek Medi Xoni SH.P.K përfaqësuar nga Ibadete Rukovci në shumën prej 120.00 Euro/muaj;
   c) Nga N.T.P "DINI" përfaqësuar nga Bedri Verbovci si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 138 me sipërfaqe prej 90 m2, e cila ndodhet në Tregun Pemë dhe Perime me Shumicë në Zonën Industriale Prishtinë tek Habib Muharremi në shumën prej 90.00 Euro/muaj;
   d) Nga Besart Islami, si qiramarrës i tezgën nr.22 e gjendur në Anex Tregun e Gjelbërt tek RTK në sipërfaqe prej 6m2 tek Enver Gashi në shumën 80.00 Euro/muaj;
   e) Nga Bajram Krasniqi si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 137 në sipërfaqe prej 112.00 m2 tek Tregu Pemë dhe Perime me Shumicë në Zonën Industriale Prishtinë tek Habib Muharremi në shumën prej 90.00 Euro/muaj;
   f) Nga Ahmet Shala si qiramarrës i tezgave nr.3/A dhe 7/A e gjendur në Tregun e Ulpianës tek Berat Shala në shumën prej 80.00 Euro/muaj;
   g) Nga Adem Govori si qiramarrës i tezgave nr.124 dhe nr.136 e gjendur në Anex Tregun e Gjelbërt tek RTK me sipërfaqe prej 2m2 për tezgë tek Arlind Veliu në shumën prej prej 30.00 Euro/muaj për tezgë apo 60 Euro/muaj;
   h) Nga Gramos Visoka si qiramarrës i tezgave nr.123 dhe nr.241 e gjendur në Tregun e Ulpianës me sipërfaqe prej 2m2 për tezgë tek Behar Hasani në shumën totale prej 80.00 Euro/muaj;
   i) Nga AS-1 Group SH.P.K si qiramarrës i pjesës së hapësirave afariste nr. 102,103,148 dhe nr.149 e cila ndodhet në Tregu Pemë dhe Perime me Shumicë në Zonën Industriale Prishtinë tek Osman Fejza në shumën prej 440.00 Euro/muaj.

II. Para lidhjes së aneks kontratave të qirasë të transferuara tek personat e lartcekur, Qiramarrësit aktual do të jenë të obliguar të paguajnë borxhin e papaguar, ose në të kundërtën do të ndërmerren të gjitha veprimet ligjore për inkasimin e borxhit të papaguar dhe lirimin e hapësirave:
   a) Besim Stublla si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr.91 tek Tregu me Shumicë në Zonën Industriale Prishtinë, në sipërfaqe prej 100m2 para bartjes së kontratës së qirasë tek N.T.P "Bizhuteria Noli" përfaqësuar nga Agim Lahu është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 1,039.84 Euro;
   b) Skender Rukovci si qiramarrës i pjesës hapësirave afariste nr.703,704,725,726 dhe 3/A e cila ndodhet në Tregun te ish-Amortizatorët para bartjes së kontratës së qirasë tek Medi Xoni SH.P.K përfaqësuar nga Ibadete Rukovci është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 110.85 Euro;
   c) N.T.P "DINI" përfaqësuar nga Bedri Verbovci si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 138 me sipërfaqe prej 90 m2, e cila ndodhet në Tregun Pemë dhe Perime me Shumicë në Zonën Industriale Prishtinë para bartjes së kontratës së qirasë tek Habib Muharremi është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 294.68 Euro;

e) **Bajram Krasniqi si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr. 137 në sipërfaqe prej 112.00 m2 tek Tregu Pemë dhe Perime me Shumicë në Zonën Industriale Prishtinë para bartjes së kontratës së qirasë tek Habib Muharremi është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 83.14 Euro;**
f) **Ahmet Shala si qiramarrës i tezgave nr.3/A dhe 7/A e gjendur në Tregun e Ulpianës para bartjes së kontratës së qirasë tek Berat Shala është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 73.90 Euro;**
g) **Adem Govori si qiramarrës i tezgave nr.124 dhe nr.136 e gjendur në Anex Tregun e Gjelbërt tek RTK me sipërfaqe prej 2m2 për tezgë para bartjes së kontratës së qirasë tek Arlind Veliu është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 349.46 Euro;**
h) **Gramos Visoka si qiramarrës i tezgave nr.123 dhe nr.241 e gjendur në Tregun e Ulpianës me sipërfaqe prej 2m2 për tezgë para bartjes së kontratës së qirasë tek Behar Hasani është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 73.90 Euro;**
i) **AS-1 Group SH.P.K si qiramarrës i pjesës së hapësirave afariste nr. 102,103,148 dhe nr.149 e cila ndodhet në Tregu Pemë dhe Perime me Shumicë në Zonën Industriale Prishtinë para bartjes së kontratës së qirasë tek Osman Fejza është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 10,474.34 Euro.**

III. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se NSh "Tregu" Prishtinë PRN104, është në proces të likuidimit që nga data 14 Korrik 2014. Kjo ndërmarrje ka vazhduar me aktivitetet e saj edhe gjatë procesit të likuidimit kryesisht në qiradhënie të hapësirave afariste.

Më datë 06.09.2024, ZR Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 25332/2024 e parashtruar nga pala Besim Stublla që kontrata e qirasë për pjesën e tokës afariste nr.91 tek Tregu me Shumicë në Zonën Industriale të transferohet në emër të N.T.P "Bizhuteria Noli" përfaqësuar nga Agim Lahu.
Qiramarrësi Besim Stublla përfaqësues i kompanisë N.T.P "Herta Tex" ka hyrë në kontratë të qirasë më datë 23.01.2015 me kontratën me nr. protokolli 337 për tokën afariste nr.91 tek Tregu me Shumicë në Zonën Industriale Prishtinë, në sipërfaqe prej 100m^2 në shumën prej 300.00 Euro/muaj. I njëjti ka kontratë aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar është 1,039.84 Euro.
Më datë 06.09.2024, ZR Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 25333/2024 të parashtruar nga Skender Rukovci për transferimin e kontratës së qirasë për hapësirat afariste nr.703,704,725,726 dhe 3/A tek Medi Xoni SH.P.K përfaqësuar nga Ibadete Rukovci. I njëjti ka kontratë aktive të qirasë dhe nuk ka borxh.
Skender Rukovci ka hyrë në kontratë të qirasë më datë 23.03.2015 me kontratën me nr. protokolli 2152/2015 për hapësirat afariste nr.703,704,725,726 dhe 3/A tek Tregu tek ish-Amortizatorët për shumën prej 110.85 Euro/muaj (qiraja e fundit). I njëjti ka kontratë aktive të qirasë në bazë të aneks kontratës me nr. protokolli 51077/2023 të datës 29.12.2023.
ZR Prishtinë më datë 06.09.2024 ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 25334/2024 për transferim të kontratës së qirasë për hapësirën afariste nr. 138 nga N.T.P "DINI" tek Habib Muharremi.
N.T.P "DINI" përfaqësuar nga Bedri Verbovci ka hyrë në kontratë të qirasë më datë 15.06.2015 me kontratën me nr. protokolli 5222/2015 për hapësirën afariste nr. 138 Tregu Pemë dhe Perime me Shumicë në Zonën Industriale Prishtinë në shumën totale prej 90 Euro/muaj, shuma e borxhit të papaguar është 294.68 Euro. Ka kontratë aktive të qirasë në bazë të aneks kontratës më nr. protokolli 50780/2023 e datës 28.12.2023.
ZR Prishtinë më datë 24.07.2024 ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 25129/2024 për transferimin e kontratës së qirasë për tezgën metalike nr. 22 nga Besart Islami tek Enver Gashi.

Besart Islami ka hyrë në kontratë të qirasë më datë 18.10.2018 në bazë të kontratës me nr. protokolli 25808/2018 për tezgën nr.22 e gjendur në Anex Tregun e Gjelbërt tek RTK në sipërfaqe prej 6m² në shumën prej 80.00 Euro/muaj. Ka kontratë aktive të qirasë në bazë të aneks kontratës me nr. protokolli 50627/2023 të datës 27.12.2023. Qiramarrësi Besart Islami nuk ka borxh të papaguar.

ZR Prishtinë më datë 06.09.2024 ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 25335/2024 për transferim të kontratës së qirasë të hapësirës afariste nr. 137 e gjendur tek Tregu Pemë dhe Perime me Shumicë në Zonën Industriale Prishtinë nga Bajram Krasniqi tek Habib Muharremi.

Bajram Krasniqi ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë më datë 18.10.2016 në bazë të kontratës me nr. protokolli 13593/2016 për hapësirën afariste nr. 137 tek Tregu Pemë dhe Perime me Shumicë në Zonën Industriale Prishtinë në shumën prej 90.00 Euro/muaj. I njëjti ka kontratë aktive të qirasë në bazë të aneks kontratës me nr. protokolli 47153/2023 të datës 21.06.2023. Po ashtu qiramarrësi ka borxh prej 83.14€ vetëm muajin shtator 2024.

ZR Prishtinë më datë 19.08.2024 ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 25265/2024 për transferimin e kontratës së qirasë për tezgën metalike nr. 3/A dhe 7/A nga Ahmet Shala në emër të Berat Shala.

Ahmet Shala ka hyrë në kontratë të qirasë më datë 05.02.2020 në bazë të kontratës me nr. protokolli 30922/2020 për tezgën nr.3/A dhe 7/A e gjendur në Tregun e Ulpianës me sipërfaqe prej 2m² në shumën prej 80.00 Euro/muaj. Ka kontratë aktive të qirasë në bazë të aneks kontratës me nr. protokolli 44049/2022 të datës 30.09.2024. Qiramarrësi Ahmet Shala ka borxh 73.90€.

ZR Prishtinë me datë 22.07.2024 ka parashtruar kërkesën me nr. protokolli 25107/2024 për transferimin e kontratës së qirasë për tezgën nr.124 dhe 136 nga Adem Govori tek Arlind Veliu;

Adem Govori ka hyrë në kontratë të qirasë më datë 27.08.2015 në bazë të kontratës me nr. protokolli 7366/2015 për tezgën nr.124 dhe në bazë të kontratës së qirasë me nr.prot. 13194/2016 e datës 06/10/2016 nr.136 e gjendur në Anex Tregun e Gjelbërt tek RTK me sipërfaqe prej 2m² për tezgë në shumën prej 30.00 Euro/muaj për tezgë apo 60 Euro/muaj . Ka kontratë aktive të qirasë në bazë të aneks kontratës me nr. protokolli 50623/2023 të datës 27.12.2023 tezga nr.136 dhe aneksit me nr.50619/2023 e datës 27.12.2023 për tezgën nr.124. Qiramarrësi Adem Govori për tezgën nr.136 ka borxh 175.23 euro kurse për tezgën nr.124 ka borxh 174.23.

ZR Prishtinë me datë 05.06.2024 ka parashtruar kërkesën me nr. protokolli 24935/2024 për transferimin e kontratës së qirasë për tezgën nr.123 dhe 241 nga Gramos Visoka tek Behar Hasani;

Gramos Visoka ka hyrë në kontratë të qirasë më datë 12.12.2022 në bazë të kontratës me nr. protokolli 44066/2022 për tezgën nr.123 dhe në bazë të kontratës me nr.protokolli 44067/2022 e datës 12.12.2022 për tezgën nr.241 e gjendur në Tregun e Ulpianës me sipërfaqe prej 2m² për tezgë në shumën prej 40.00 Euro/muaj për tezgë apo 80Euro/muaj. Ka kontratë aktive të qirasë në bazë të aneks kontratës me nr. protokolli 50475/2023 të datës 26.12.2023 për tezgën nr.123 dhe aneks kontratën e qirasë me nr.prot.50474/2023 e datës 26.12.2023 për tezgën nr.241 . Qiramarrësi Gramos Visoka për tezgën nr.123 ka borxh 36.95 euro kurse për tezgën nr.241 ka borxh 36.95.

ZR Prishtinë më datë 20.06.2024 ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 24993/2024 për transferim të kontratës së qirasë për hapësirën afariste nr. 102,103,148 dhe nr.149 nga AS-1 Group tek Osman Fejza kurse toka afariste me nr.87 dhe 88 të mbetët në emër të AS-1 Group SH.P.K.
AS-1 Group SH.P.K tani nga përfaqësuar nga drejtori menaxhues Habib Fejza ka hyrë në kontratë të qirasë më datë 21.01.2021 me kontratën me nr. protokolli 34474/2021 për hapësirat afariste nr.87,88, 102,103,148 dhe nr.149 tek Tregu Pemë dhe Perime me Shumicë në Zonën Industriale Prishtinë në shumën totale prej 660 Euro/muaj, shuma e borxhit të papaguar e cila figuron është 10,474.34 Euro.
Qiramarrësi AS-1 Group SH.P.K ka kontratë aktive të qirasë në bazë të aneks kontratës më nr. protokolli 50727/2023 e datës 28.12.2023. Në bazë të një njoftimi me nr.prot.23298/2023 e datës 13/10/2023 të dorëzuar tek

ish inkasanti i NSH Tregu z.Shefqet Muqiqi, palët kanë njoftuar se nga data 01/04/2023 toka afariste me nr.87 dhe 88 duhet të vazhdojë të qëndroj në emër të AS-1 Group SH.P.K kurse toka afariste nr.102,103,148 dhe 149 janë të mbyllura prej datës 01/03/2023, pasi që në bazë të pronarit të AS-1 Group SH.P.K vëllezërit do të ndajnë biznesit si dhe lokacionet.
Prandaj, më 20/06/2024 Osman Fejza, vëllau i Habib Fejzës (AS-1 Group SH.P.K) ka bërë kërkesë që toka afariste nr.102,103,148 dhe 149 të kalojnë në emër të tij për arsye të ndarjes së bizneseve. Z. Osman Fejza është shfrytëzues faktik (në bazë të vizitave në terren) prandaj edhe ka adresuar kërkesën që këto hapësira të kalojnë në emër të tij. Po ashtu pala na ka njoftuar që deri në ndryshim të kontratës nuk mund të bëjnë pagesa më si AS-1 Group dhe për atë arsye edhe borxhi ju është grumbulluar.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i kontratave të qirasë do te mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të hyrave vjetore, duke mundësuar kështu rritjen e ndjeshëm te fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 shtator 2024

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www. pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-210/38

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në, Nenit 10.1.5 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Nenit 3.13.1 të Rregullores Nr. 8/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, Neneve 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me 30 shtator 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të:

a) **Lokali nr.19 me sipërfaqe 25.43m² - Tregu i Gjelbër (te RTK) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 213.00 € për një muaj për parashtruesin e kërkesës Flakon Berisha;**

b) **Lokalin nr.47 me sipërfaqe 13.00m² - Tregu i Gjelbër (te RTK) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 109.00 € për një muaj për parashtruesin e kërkesës Ilmi Ymeri;**

c) **Kioska e betonit nr.6 me sipërfaqe 1.36m² - Tregu i Gjelbër (te RTK) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 24.00 € për një muaj për parashtruesin e kërkesës Fahrije Selmani;**

d) **Kioska e betonit nr.226 me sipërfaqe 1.36m² - Tregu i Gjelbër (te RTK) sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 24.00 € për një muaj për parashtruesin e kërkesës Trimnesha Gajtani Kalaja;**

II. Para lidhjes së marrdhënies kontraktuale Qiramarrësit janë të detyruar të paguajnë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, ashtu që për periudhën retroaktive parashtruesit e kërkesave para nënshkrimit të kontratave të qirasë do të duhet të paguajnë shumat si në vijim:

a) **Për lokalin nr.19 me sipërfaqe prej 25.43 m2 parashtruesi i kërkesës Flakon Berisha do të duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzimin pa kontratë të qirasë që nga data 01 gusht 2024 shumën prej 639.00€, respektivisht për muajt korrik, gusht dhe shtator 2024;**

b) **Për lokalin nr.47 me sipërfaqe prej 13.00 m2 parashtruesi i kërkesës Ilmi Ymeri do të duhet të pagujë retroaktivisht për shfrytëzimin pa kontratë të qirasë që nga data 01 gusht 2024 shumën prej 327.00€, respektivisht për muajt korrik, gusht dhe shtator 2024;**

c) **Për kioskën e betonit nr.6 me sipërfaqe prej 1.36 m2 parashtruesi i kërkesës Fahrije Selmani do të duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzimin pa kontratë të qirasë që nga data 01 gusht 2024 shumën prej 72.00€, respektivisht për muajt korrik, gusht dhe shtator 2024;**

d) **Për kioskën e betonit nr.226 me sipërfaqe prej 1.36 m2 parashtruesi i kërkesës Trimnesha Gajtani Kalaja do të duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzimin pa kontratë të qirasë që nga data 01 gusht 2024 shumën prej 72.00€, respektivisht për muajt korrik, gusht dhe shtator 2024;**

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qirave direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si ne vijim:

MH.

Me datë 22.07.2024 Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë, ka pranuar shkresën me nr. protokolli 25112/2024, të parashtruar nga Flakon Berisha me të cilën ka kërkuar të marrë me qira përmes qiradhënies direkte hapësirën afariste/ kioskën nr.19 e cila është pronë e NSh Tregu, dhe gjendet në Tregun e Gjelbër.
Me datë 22.07.2024 Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë, ka pranuar shkresën me nr. protokolli 25110/2024, të parashtruar nga Ilmi Ymeri me të cilën ka kërkuar të marrë me qira përmes qiradhënies direkte hapësirën afariste/kioskën nr.47 e cila është pronë e NSH Tregu, dhe gjendet në Tregun e Gjelbër.
Me datë 25.07.2024 Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë, ka pranuar shkresën me nr. protokolli 25138/2024, të parashtruar nga Fahrije Selmani me të cilën ka kërkuar të marrë me qira përmes qiradhënies direkte të hapësirën afariste/kioskën nr.06 e cila është pronë e NSh Tregu, dhe gjendet në Tregun e Gjelbër.
Me datë 25.07.2024 Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë, ka pranuar shkresën me nr. protokolli 25140/2024, të parashtruar nga Trimnesha Gajtan Kalaja me të cilën ka kërkuar të marrë me qira përmes qiradhënies direkte hapësirën afariste/kioskën nr.226 e cila është pronë e NSh Tregu, dhe gjendet në Tregun e Gjelbër

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DE 376/2024 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë për asetet të cilat nuk kanë mundur ti sigurojnë herën e parë me vendimin e DE 349/2024, prandaj bazuar në informatat e siguruara, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren janë matur asetet mëposhtme dhe çmimi i hapësirave të ofruar me qira NSh Tregu tek tregu i Gjelbër duhet të jetë sipas matjeve të paraqitura në raportin e vlerësimit.

Në bazë të konfirmimit edhe nga ana e Udhëheqësit të Ofruesit të Shërbimeve tek Tregu i Gjelbër (tek RTK) palët kanë filluar shfrytëzimin e këtyre hapësirave nga datat të cilat kanë kërkuar njëherësh të hyjnë me qira. Andaj, nga palët do të kërkohet që para nënshkrimit të kontratës të paguajnë shumën e qirasë në mënyrë retroaktive nga datat e kërkesave të tyre. Kontratat e qirasë do të lidhen me efektivitet nga data 01.10.2024.
Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesit e këtyre kërkesave, tanimë edhe shfrytëzuesit e këtyre hapësirave do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Prona e cila do të vlerësohet për dhënie me qira, sipas dokumentacionit të poseduar nga AKP, ZR Prishtinë, dhe sipas listës së aseteve, është tokë afariste përkatësisht treg.
Këto hapësira nuk janë në listën e aseteve të cilat i janë propozuar Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me strategjinë për krijimin e Fondit Sovran. Më parë këto hapësira nuk janë tenderuar ndonjëherë për qiradhënie përmes tenderit publik për qira për arsye se NSh Tregu dhe asetet e saja janë me karakter specifik. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 shtator 2024

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-210/39

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në, nenit 10.1.5 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve, nenit 3.13.1 të Rregullores Nr. 8/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me 30 shtator 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të sipërfaqes prej 130m2 të një pjese të parcelës me nr.528-0 në ZK Ferizaj në pronësi të GJI012 NSh "Plantacioni" Ferizaj, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 158.16 në muaj.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit/AL-ës sa i përket kësaj qiradhënie dhe mori vendimin për refuzimin e kërkesës dhe tenderimin publik të pronës per faktin se qiradhënia publike e këtij aseti do të vazhdonte të rriste vlerën e fondeve të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore, fonde këto që do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve dhe përfundimisht buxhetit të Kosovës për të mira publike, si përfitues nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët. Shpallja e tenderit publik për këtë aset, do të rriste konkurueshmërinë dhe mund te arrihen çmime më të larta qe do mundësonin të ardhura të vazhdueshme dhe të sigurta dhe eliminonin nevojën e sigurimit të pronës dhe monitorimit të shpeshtë nga uzurpimet e mundshme prej personave të papërgjegjshëm.

Duke pas parasysh se pala është duke e shfrytëzuar një pjesë të parcelës sipas kërkesës së parashtruar pranë zyrave të AKP-së nga viti 2015 me leje dhe kontratë të lëshuar nga ana e KK Ferizaj por pa e ditur se është në pronën e NSh-së, Bordi udhëzoi që të parashtrohet padi ndaj palës shfrytëzuese ose KK Ferizaj si qiradhënës që të bëj kompenzimin në emër të shfrytëzimit të paligjshëm apo pasurimit të pabazë.
Duke marrë parasysh gjitha këto që u cekën më lart, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 shtator 2024

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www. pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD/210/40

Në bazë të nenit 15.2.7të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 40, 41.4 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen mbajtur me datë 30 shtator 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet Raporti i Shpërndarjes së Përkohshme të pjesshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e GJI004 NSh IDGJ Tobacco Industry (në likuidim) nga Rajoni i Gjilanit me 318 kreditor të përfshirë, në shumë totale 1 148, 900.59€ për pagesë.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim të Shpërndarjes së Përkohshme të pjesshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e GJI003 NSh IDGJ Tobacco Industry (në likuidim) nga Rajoni i Gjilanit.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin Korrigjues të Shpërndarjes së Përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e GJI003NSh IDGJ Tobacco Industry (në likuidim) nga Rajoni i Gjilanit.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 shtator 2024.

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD/210/41

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30 shtator 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet Raporti i Shpërndarjes së Përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRN115 - NSh Ratar Laplje Selo(në likuidim) nga Rajoni i Prishtines me 1 kreditor të përfshirë, në shumë totale 359,630.70€ për pagesë.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim të Shpërndarjes së Përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRN115 - NSh Ratar Laplje Selo (në likuidim) nga Rajoni i Prishtine.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin Korrigjues të Shpërndarjes së Përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRN115 - NSh Ratar Laplje Selo (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 shtator 2024.

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-210/42

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregulloren Nr. 04/2023 Për Politikat dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Nenit 42 i Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore Ligji Nr. 2003/11 për Rrugët, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 shtator 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga aseti siç përshkruhet në certifikatën pronësore me nr. P-71611039-00079-29 ZK Jabllanicë me sipërfaqe prej 570 m² dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti, pronë e NSh "KBI Bujqësia" PEJ055.**

II. **Pas aprovimit të kësaj kërkese nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.**

III. **Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga aseti respektivisht nga prona e NSh "KBI Bujqësia" PEJ055 sipas përshkrimit në dispozitiv të këtij vendimi.

